




**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**



**Drejtoria Komunale për Prokurim Publik**  
**14 Nr. 710/23**  
**Dt. 26.07.2023**

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. “ Eko Term “sh.p.k. me seli në Suharekë, kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik për Dhënie të Kontratës të publikuar më dt. 18.07.2023, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 63.1.2 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, më datën 26.07.2023 bie këtë:

**V E N D I M**

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** Kërkesa për rishqyrtim, e subjektit në procedurë : “ Eko Term “sh.p.k. me seli në Suharekë e datës 24.07.2023, për rishikimin - rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit kundër vendimit mbi Njoftimin e Autoritetit Kontraktues të datës 18.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit : “ Ndërtimi i depove në shkolla “ me nr. të prokurimit : Nr. Prok: VU644 – 23 – 4869 – 5-2-1 / Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 058 – 521
2. Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së dhe nenin 63.1.3 pika ( a ) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik do të anuloi Vendimin paraprak të ankimuar nga Ankuesi dhe do të vazhdoi me procesin e ri vlerësimit të aktivitetit të prokurimit.
3. Vendimi hynë në fuqi ditën e marrjes.

**A r s y e t i m**

Me vendimin e sajë, Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ka marrë vendim që , në aktivitetin e prokurimit : “ Ndërtimi i depove në shkolla “ me nr. të prokurimit : Nr. Prok: VU644 – 23 – 4869 – 5-2-1 / Nr. i Brendshëm: VU644 – 23 – 058 – 521 , të shpërblej me kontratë Operatorin Ekonomik : “ L-Group “sh.p.k. me seli në Prishtinë.

Në Kërkesën për rishqyrtim parashtruar nga Op. Ek. “ Eko Term “sh.p.k. me seli në Suharekë ( në tekstin e mëtejshëm Ankuesi ) e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor, parashtruesi i Kërkesës konsideron se me këtë rast janë shkelur dispozitat e LPP-së, neni – 1 Qëllimi, 7- Barazia në Trajtim/ Jo diskriminimi, neni – 56 – Dispozitat e përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratës , nenin - 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës, nenin 65 – Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, neni 66 – Përshtatshmëria Profesionale dhe neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Pasi u shqyrtuan pretendimet e Ankuesit të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, me theks të veçantë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të dëshmive dhe / ose dokumenteve të dorëzuara nga O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës të dorëzuara mbi bazën e Kërkesës së A.K. drejtuar O.E. për informacione shtesë lidhur me përmbushjen e kërkesave mbi aftësitë teknike dhe / ose profesionale të saktësuara në Dosjen e Tenderit, pjesa FTD, nenin 9.1 lidhur me 9.2, pika 4, u konstatua se dëshmitë dhe / ose dokumentet e dorëzuara për të dëshmuar përmbushjen e Kërkesave të cekura si më lartë është e

domosdoshme që edhe njëherë të vlerësohen dhe ekzaminohen saktë, andaj, rrjedhimisht, Kërkesa për Rishqyrtim e Ankuesit u vlerësua të jetë pjesërisht e bazuar.

Sikurse ka vlerësuar A.K., dëshmitë e O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës , të dorëzuara sipas Kërkesës për sqarim tenderi, për të dëshmuar përmbushjen e pikës 4 të Kërkesave si në FTD, neni 9.1 lidhur me 9.2, saktësisht : dëshmitë lidhur me posedimin e pajisjeve teknike, si vijon : një Eskavator gërmues /ngarkues dhe 2 kamion vetëshkarkues me peshë bartëse min. 10 ton, rezultojnë të jenë jo të rregullta sepse nuk ka të dhëna se janë në pronësi të O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës. Bazuar në të dhënat nga dokumentet e dorëzuara, libreza e qarkullimit për kamionët dhe, DUD-i Doganor për Eskavatorin, pajisjet rezultojnë të jenë të një O.E. tjetër, me të cilin O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka dëshmi bashkëpunimi ose të drejtë shfrytëzimi, ashtu sikurse është kërkuar në Dosjen e Tenderit, pjesa FTD , neni 9.1 lidhur me 9.2 , pika 4 , citat : “ Lista e mjeteve, pajisjeve mbi makinerinë e cili duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur. Mjetet dhe pajisjet duhen të dëshmojnë me njërin prej këtyre dokumenteve : me librezën e regjistrimit, faturë, librezë, DUD doganorë apo marrëveshjen mbi qiranë e cila duhet të jetë e nënshkruara dhe vulosur nga të dyja palët “ mbarim citati. Rrjedhimisht, mungesa e dëshmimeve të rregullta, tenderin e O.E. të rekomanduar për dhënie të kontratës, sikurse mendon A.K. , e bënë të papërgjegjshëm sepse kjo mangësi e konstaur nga A.K. paraqeset devijim substancial nga kërkesat e dosjes së tenderit. Mungesa e dokumentit në fjalë përbënë largim dhe kufizim thelbësorë nga Kërkesat e Dosjes së Tenderit për arsye se :

- Dallonë esencialisht nga kushtet dhe kërkesat e saktësuara në dosjen e tenderit dhe
- Shtrembëron konkurrencën e tenderuesve, ofertimet e të cilëve janë në pajtueshmëri me rregullat dhe kërkesat e saktësuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin oper Kontratë, dhe si të tilla këto mangësi e bëjnë tenderin e Ankuesit të papërgjegjshëm.

Lidhur me pretendimin e Ankuesit se O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës ka plotësuar, vulosur dhe nënshkruar Deklaratën nën Betim, ndërkaq ka dështuar që ti plotësoi Kërkesat e Përshtatshmërisë , sa i përket përmbushjes së Kërkesave lidhur me aftësitë teknike dhe / ose profesionale, A.K. vlerëson se “ Deklarata nën Betim “ në procesin e vlerësimit të tenderit është kusht Administrativ, të cilin , sikurse konstaton A.K. , O.E. i rekomanduar për dhënie të kontratës e ka përmbushur ndërsa, kërkesat nga neni 9.1 lidhur me 9.2 të janë Kërkesa teknike profesionale, që janë të një natyre dhe kriteri tjetër të kualifikimit dhe të përzgjedhjes andaj, A.K. këtë pretendim e konsideron si të paqëndrueshëm. Megjithatë kjo çështje nëse konsiderohet e nevojshme për rishqyrtim mbetet të interpretohet gjatë procesit të rivlerësimit të tenderëve.

#### **Këshillë juridike:**


**Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtrori Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.**

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë  
K.R.. nr. 058/2023, datë 26.07.2023

Aktvendimi i dërgohet:

1. Palës/ ve
2. DKP
3. Arkivit (1 kopje)

**Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik**

  
**Alban Tahiraj**